

Përmbajtja

Faqe 2

"Korrupsioni në Shoqërinë tonë: Çka të bëjmë për ta luftuar?"

"Diplomacia, Negociatat dhe Shoqëria Civile"

"Guximi Civil" debat me Dr. Svetlana Broz

Faqe 3

Së bashku kundër trafikimit të njerëzve

Kryetar i ri i "AGPK"

Qendra për Studime Gjinore i ka dërguar OKB-së raport për dhunën ndaj femrave në Kosovë

Faqe 4

Menaxhim i Sektorit të Sigurisë

Shoqëri Aktive

Dokumentim i të drejtave të njeriut nëpërmjet kinemasë

Faqe 5

Zhvillime Ndërkombëtare të Shoqërisë Civile

Mundësi të reja për financim mund të gjenden në Web faqen e ATRC-së: <http://www.advocacy-center.org/>



ATRC formalizon bashkëpunimin e ri me IREX-in, Programin Kosovar për Shoqëri Civile

Në shtator ATRC formalizoi marrëveshje bashkëpunimi me IREX-in për të përkrahur zhvillimin e OJQ-ve kosovare në kuadër të Programit Kosovar për Shoqëri Civile, financuar nga USAID.

Gjatë disa muajve të kaluar, kemi punuar në ngritjen e kapaciteteve të resurseve tona dhe në zgjerimin e portfolios së shërbimeve tona, për t'i shërbyer sa më mirë nevojave të OJQ-ve. Nëpërmjet rolit tonë si qendër e trajnimeve, resurseve dhe informimit për OJQ, ATRC po punojnë në fuqizimin e autonomisë, efektivitetit, qëndrueshmërisë dhe ndikimit të sektorit të OJQ-ve si katalizator kryesorë në zhvillimin e një shoqërie aktive civile e cila është aktive dhe të një qeverisjeje të përgjegjshme demokratike.

Si organizatë që ju shërben të tjerëve, programet e ATRC-së janë të dizajnuara t'i plotësojnë nevojat aktuale dhe ato në zhvillim e sipër të OJQ-ve. Shërbimet tona përfshijnë trajnime dhe konsul-



Takim informativ i ATRC, IREX dhe FDI në Prishtinë

time bazike e të avancuara në fusha kyçe të zhvillimit organizativ të OJQ-ve, menaxhimit, avokimit dhe mbledhjes së fondeve; informata elektronike nëpërmjet web faqes sonë, marketingut dhe komunikimit, debateve publike dhe tryezave të rumbullakëta, ndërtimit të koalicioneve dhe fasilitimit të bashkëpunimeve ndër-sektoriale. Në nëntor, ATRC zhvilloi pesë punëtori për Dizajnim të Projekt Propozimeve për OJQ-të e interesuara të aplikojnë për rundin e parë të granteve të IREX/FDI për Partneritet dhe Rrjetëzim. Punëtoritë u mbajtën në Prishtinë dhe Mitrovicë Veriore dhe kanë tërhequr një numër prej 148 pjesëmarrësve, përfaqësues

të 108 OJQ-ve nga të gjitha rajonet e Kosovës.

Ndërkohë, jeni të mirëseardhur të lexoni edicionin e fundit të "The Advocate", buletinit dymujor të ATRC-së për dhe rreth komunitetit të OJQ-ve të Kosovës. Shpresojmë të jetë informativ dhe i dobishëm. Komentet dhe sugjerimet tuaja gjithmonë janë të mirëseardhura dhe të çmuara. Nëse dëshironi të kontribuoni në edicionet e ardhshme të buletinit me ndonjë storie suksesi ose artikull të shkurtë rreth ndikimit të punës së juaj në shoqëri, ju lutemi të na kontaktoni. Kemi kënaqësinë të punojmë me ju në të ardhmen dhe ju mirëpresim në ATRC.

Për të mësuar më shumë rreth shërbimeve të zgjeruara të ATRC-së dhe për të diskutuar se si ne mund t'i ndihmojmë OJQ-së suaj, ju ftojme të na vizitoni në Qendrën tonë ose na kontaktoni në 038 244 810

Mundësi për Financim të OJQ-ve

Banka Botërore financon ide inovative për krijimin e vendeve të reja të punës në Ballkanin Perëndimor

Banka Botërore fton të gjitha organizatat e interesuara, asociacionet dhe institucionet të dorëzojnë ideja inovative për krijimin e vendeve të punës në sektorin formal. Propozimet më të mira prej Kosovës, Bosnje dhe Hercegovinës, Shqipërisë, Maqedonisë dhe Serbisë e Malit të Zi do të fitojnë rreth 35,000 dollarë për projekt, si pjesë e programit Zhvillimi i Tregut në Ballkanin Perëndimor për 2006. Zhvillimi i Tregut në Ballkanin Perëndimor pasqyron vendosshmërinë e Bankës Botërore për përkrahjen e pu-

nësimit si një ndër sfidat më të mëdha të të gjitha shteteve në rajon. Zhvillimi i Tregut në Ballkanin Perëndimor për 2006 është e hapur për grupe të ndryshme: shoqëri civile, ndërmarrësit social, fondacionet private, agjencionet qeveritare, akademitë dhe sektorin privat. Në secilën nga vendet pjesëmarrëse, do të ketë ekip vlerësimi i cili përbëhet nga ekspert prominent, dhe të cilët do të bëjnë selektimin e finalistëve. Konsideratë të veçantë do të kenë projektet të cilat demonstrojnë mundësinë për të promovuar punësimin e të


rinjve si dhe bashkëpunimin regjional apo përtej kufijve. Propozimet duhet dorëzuar me email, postë apo t'i dorëzoni personalisht deri më datën 30 janar, 2006 deri në ora 17:00. Për më shumë informata rreth këtij programi, të drejtës për aplikim, kritereve vlerësuese, si të aplikoni dhe të dhënavë kyçe, ju lutemi drejtoheni në ueb faqen <http://www.worldbank.org> ose kontaktoni Shpend Ahmetin në Bankën Botërore, zyra në Kosovë, në emailin: sahmeti@worldbank.org apo në tel: 038 249 459/248 780.

NGO Flash Lajme

Debati "Guximi Civil" me Svetlana Broz

Çështja e "Guximit Civil" u diskutua me 30 nëntor në Galerinë e Arteve, mes Svetlana Broz, mbesa e ish-kryetarit të Jugosllavisë, Josip Broz Tito dhe qytetarëve të Kosovës. Debati u organizua nga Klubi Republikan dhe Këshilli për Mbrojtjen e të Drejtave dhe Lirive të Njeriut.

Znj. Broz bisedoi për përvojat e saj dhe përmendi shembuj praktik të guximit civil. Pas fillimit të luftës në Bosnjë dhe Hercegovinë më 1992, Znj. Broz u paraqit vullnetare si kardiologe, ku ajo filloi të intervistonte për librin, i cili përshkruan përvojat njerëzore gjatë Luftës Boshnjake. Këto përvoja u botuan në librin e saj "Njerëz të Mirë në një Kohë të Keqe" i publikuar më 1999. Libri është përkthyer në shumë gjuhë. Drejtoresha e OJQ-së Sarajevase GARIWO, Svetlana Broz është mjaft e njohur për ligjëratat e saj në vende të ndryshme mbi rëndësinë e guximit civil. Gjatë viteve të kaluara ajo ka ligjëruar në Universitete dhe Institucione Ndërkombëtare të ndryshme në Shtetet e Bashkuara të Amerikës, si dhe në Londër, Berlin, Gjenevë, Lozanë, Grac, Pragë, Milano, Bolzano, Varshavë, Amsterdam, Hagë, Braunshvig, Marsej, Lilehamer, Oslo, etj.



Libri i Dr. Svetlana Broz "Njerëz të Mirë në një Kohë të Keqe"

Debat publik i ATRC-së dhe ÇOHU-t

"Korrupsioni në Shoqërinë tonë: Çka të bëjmë për ta luftuar?"

"Nuk është koha të vendosim billboarda pa fytyra, por të zbatojmë ligje të cilat e luftojnë korrupsionin", theksoi Igballe Rogova, përfaqësuese Rrjetit Kosovar të Grave.

ATRC dhe OJQ-ja vendore, Organizata për Demokraci, Antikorrupsion dhe Dinjitet 'Çohu' organizoi një debat publik gjithëpërfshirës me 5 dhjetor në zyrat e ATRC-së, që të diskutojnë dhe shqyrtojnë mekanizmat që përdoren në Kosovë të luftohet korrupsioni. Në debat ishin prezent

përfaqësues të OJQ-ve, Qeverisë dhe Mediave, i cili u moderua nga Anton Ndreca, anëtar i "Çohu".

Panelistë për debat ishin Habit Hajredini - Zyra për Qeverisje të Mirë, Bashkim Rrahmani - Fondacioni për Iniciativa Demokratike "FID", Igballe Rogova - Rrjeti Kosovar i Grave, Sejdi Osmani - RIINVEST dhe Fatmire Tërdevci - Koha Ditore.

Diskutimi u hap nga Barbara Hall, Shefe e Grupit IREX Programi Kosovar për Shoqëri Civile, e cila diskutoi ro-

lin e shoqërisë civile në luftimin e korrupsionit. Znj. Hall theksoi se kredibiliteti dhe legjitimiteti janë qenësore për



Pjesëmarrësit debatojnë korrupsionin në Kosovë

një rol efektiv të shoqërisë civile në luftimin e korrupsionit. Panelistët komentuan në nevojën e një koalicioni të fortë antikorrupsion, të shoqërisë civile. Ndonëse, Z. Hajredini, Zyra për Qeverisje të Mirë, tha se ligje të rëndësishme për të luftuar korrupsionin janë formuluar dhe miratuar në Kosovë, pjesëmarrësit tjerë u përgjigjën se sektori i OJQ-ve dhe mediave ka nevojë për zbatimin e ligjeve dhe qasje në dokumentet zyrtare.

Sejdi Osmani prezantoi një anketë publike të RIINVEST-

it të publikuar me 5 nëntor, për shtrirjen dhe pasojat e korrupsionit në Kosovë. Anketat tregojnë se 72% prej 600 kompanive të vogla dhe të mesme, të përfshira në anketë, mendojnë se korrupsioni është i përhapur në Kosovë. Mungesa e mekanizmave institucionale dhe moszbatimi i ligjeve, janë ndër burimet kryesore të korrupsionit, përfundoi kjo anketë.

Gazetarët nuk mund të vazhdojnë hulumtimet në korrupsion, për shkak të moslejimit të kenë qasje në dokumente zyrtare, theksoi gazetarja e Kohës Ditore, Fatmire Tërdevci.

Shumica e panelistëve dhe pjesëmarrësve u pajtuan se shoqërisë Kosovare i duhet zbatimi i ligjit antikorrupsion, ndjekja e personave të korrumpuar, një koalicion gjithëpërfshirës dhe më tepër debate, që të arrihet një luftë efektive kundër korrupsionit.

Tryezë e rrumbullakët e ATRC-së, FDI-së dhe IREX-it

"Diplomacia, Negociatat dhe Shoqëria Civile"

ATRC, FDI dhe IREX organizojnë tryezë të rrumbullakët me përfaqësues të OJQ-ve të Kosovës dhe Miroslav Lajçak, Drejtor i Përgjithshëm për Çështje Politike në Ministrinë e Punëve të Jashtme të Sllovakisë, me 6 dhjetor në zyrat e ATRC-së. Diskutimi

ishite rreth rolit të shoqërisë civile në krijimin e themelit për një shoqëri shumë etnike Kosovare. Z. Lajçak informoi për përvojat e vendit të tij, duke u fokusuar në OJQ-të Sllovaqe dhe rolit të tyre të partneritetit me qeverinë.

Drejtor i Përgjithshëm për Çështje Politike në Ministrinë e Punëve të Jashtme të Sllovakisë theksoi rolin e rëndësi-



Tryezë të rrumbullakët me përfaqësues të OJQ-ve të Kosovës dhe Miroslav Lajçak në ATRC

shëm të cilin shoqëria civile mund t'a luaj në forcimin e dialogut dhe shpejtimin e procesit për pajtimin dhe vendosjen e multietnicitetit në Kosovë.

"Ju duhet të dilni nga klishetë dhe të filloni komunikimin për gjëra konkrete, si të jetoni pranë njëri-tjetrit" tha Lajçak. Përfaqësuesit e OJQ-ve, potencuan se shoqëria civile ka luajtur një rol kyç në Kosovën

e pas luftës, posaçërisht në forcimin e dialogut ndëretnik. Lajçak informoi pjesëmarrësit se Sllovakia ofron të organizojë një takim në Bratisllavë në mes të OJQ-ve Kosovare dhe Serbe, në mënyrë që të shikohet se si të dy palët do të mund të komunikojnë me njëra-tjetrën.

Prej vitit 2001 deri më 2005, Miroslav Lajçak shërbeu si Ambasador i Sllovakisë në Republikën Federale të Jugosllavisë (më vonë Serbia dhe Mali i Zi), Shqipëri dhe Maqedoni.

Mundësi Financimi për OJQ-të Kosovare të cilat janë të interesuara të aplikojnë për fonde të Qeverisë Sllovaqe, mund të gjenden në www.foreign.gov.sk

NGO Flash Lajme**Së bashku kundër trafikimit të njerëzve**

Shoqata e avokateve "Norma" dhe Organizata Ndërkombëtare për Migrim "IOM" ka mbajtur një grup punues më 21 tetor në zyrat e ATRC-së, fokusuar në qëllimin dhe cakun e trafikimit të qenieve njerëzore.

Pjesëmarrësitë, përfaqësuesë të tetë OJQ-ve lokale nga të gjitha qytetet e Kosovës dhe nga grupe të ndryshme etnike, përfshirë shqiptarë, serbë, boshnjakë, turq dhe romë analizuan raste të ndryshme studimore të trafikimit të njerëzve. Ata gjithashtu shikuan dhe diskutuan filmin "Lilja 4-Ever", i regjisorit Lukas Moodysson. Filmi rrefen ngjarje të vërtetë të një rasti trafikimi të dy fëmijëve, Lilja dhe Volodya, të cilët jetojnë në një vend që dikur ishte pjesë e perandorisë sovjetike. Rregullorja e UNMIK-ut 2001/4 për "Ndalimin e Trafikimit të Personave në Kosovë", po ashtu i është prezantuar pjesëmarrësve. Kjo rregullore përcakton se 'trafikimi i personave' do të thotë angazhim, transportim, transferim, strehim ose pranim të personave, me anë të kërcënimit, përdorimit të forcës, rëmbimit, mashtrimit, keq përdorimit të pozitës, ose dhënies apo marrje të pagesave apo përfitimeve.

Ky grup punues është pjesë e projektit të IOM-it "Së bashku kundër trafikimit të njerëzve".



Filmi "Lilja 4-Ever" i regjisorit Lukas Moodysson

Emërim i Ri**Fatos Bytyçi është zgjedhur kryetar i ri i Asociacionit të Gazetarëve Profesionistë të Kosovës "AGPK"**

Fatos Bytyçi, gazetar i Radio Televizionit të Kosovës, është zgjedhur kryetar i ri i Asociacionit të Gazetarëve Profesionistë të Kosovës gjatë kuvendit të dytë, të mbajtur më 23 tetor në Hotelin Grand, Prishtinë.

Bytyçi ka premtuar se gjatë mandatit të tij një vjeçar në krye të asociacionit, do të punojë për të siguruar kushte më të mira pune për të gjithë gazetarët kosovarë.

"Do të punojmë në favor të interesave të të gjithë gazetarëve për mbrojtje më të mirë, me qëllim që t'i jepet fund dhunës ndaj gazetarëve, kameramanëve dhe foto reportereve", ka theksuar Bytyçi.

Kë këtë kuvend u zgjodhën shtatë anëtarë të bordit nga gjithsej 13 kandidatë.

Anëtarët e zgjedhur të bordit

janë: Fatos Bytyçi, Astrit Gashi, Syzana Bytyçi, Ibrahim Rexhepi, Lindita Camaj, Berat Buzhala dhe Artan Mustafa.

Përfaqësuesë të USAID dhe Federatës Ndërkombëtare të Gazetarëve përsëritën kuvendin e AGPK-së. "Roli i të gjithëve duhet të jetë mbrojtja e gazetarëve dhe përmirësimi i kushteve të tyre të punës", ka deklaruar Oliver Money, përfaqësues i Federatës Ndërkombëtare të Gazetarëve. Drejtori i Zyrës për Demokraci në USAID, Miles Toder u ka thënë gazetarëve se publiku duhet ta çmojë rolin e gazetarisë së mirë.

Asociacioni i Gazetarëve Profesionistë, i themeluar më



Votimi në AGPK

2002, është organizatë jo profitabile e cila është zotuar të rritë profesionalizmin e gazetarëve dhe mediave kosovare. Ky është i vetmi asociacion në Kosovë që mbron të drejtat e gazetarëve dhe ka më shumë se 360 anëtarë.

AGPK-ja është anëtare e Federatës Ndërkombëtare të Gazetarëve.

Qendra për Studime Gjinore i ka dërguar OKB-së raport për dhunën ndaj femrave në Kosovë

Në bashkëpunim me pesë anëtare të Rrjetit të Grave të Kosovës (Asebe, Qendra për Mbrojtjen e Grave dhe Fëmijëve, Shtëpia e Sigurt Gjakovë dhe Qendra për Mirëqenie të Grave), Qendra Kosovare për Studime Gjinore ka hartuar dhe i ka dërguar OKB-së këtë raport më 15 tetor, për ta informuar për dhunën ndaj femrave në Kosovë. Pjesë të mëposhtme të raportit përmbajnë praktika të mira të femrave kosovare në luftimin e dhunës ndaj femrave

Femrat kosovare në shoqërinë civile avokojnë për nxjerrje ligjesh kundër dhunës ndaj femrave, sigurojnë këshillime dhe ndihmë femrave që pësojnë nga dhuna, dhe ngritin vetëdijjen për këtë çështje. Disa shembuj të praktikave të mira janë:

Praktikat e Mira të Shtëpive të Sigurta

Pas luftës, Qendra për Mbrojtjen e Grave dhe Fëmijëve ndihmoi 1,960 viktimat të dhunuara të luftës, përfshirë 29 femra të moshës së re, të cilat u ndihmuan të abortojnë shtatzënësi të dhunshme të luftës. Femrat kosovare në shoqërinë civile me sukses kanë formuar dhe drejtuar pesë shtëpi të sigurta në rajone të ndryshme të Kosovës. Fushata e Rrjetit të Grave të Kosovës kundër Dhunës ndaj Femrave



OKB-ja po bën hulumtim mbarë botëror për dhunën ndaj femrave, përfshirë Kosovën

Më 2001, ky rrjet koordinoi një fushatë, e cila përdori artin dhe teatrin për të ngritur dijeninë publike për problemin e dhunës ndaj femrave, përfshirë dhunën shtëpiake, dhunimin gjatë kohës së luftës dhe më pas, trafikimin dhe prostitucionin.

Fushata Lilja Përgjithmonë Më 2004, një koalicion i organizatave lokale dhe ndërkombëtare koordinuan fushatën për ngritje të vetëdijes "Lilja

Përgjithmonë" ndaj trafikimit të grave dhe vajzave.

Përkrahja Juridike

Femrat kosovare në shoqërinë civile kanë organizuar përkrahje juridike për viktimat e dhunës.

Adresim i Traumave të Pas Luftës në mesin e Meshkujve dhe Femrave

Pas luftës, aktivistë kosovar siguruan përkrahje psiko-sociale për viktimat e dhunës. Aktivistët vërejtën nivele më të ultë të dhunës ndaj femrave në zonat ku aktivistët pas luftës bënë përpjekje të shtuara për të punuar me meshkuj, si kurse edhe me femra të traumatizuara.

Për raport të plotë ose më shumë informata, ju lutem kontaktoni Qendrën Kosovare për Studime Gjinore në 038 540 719 ose vizitoni www.kgscenter.org.

NGO Flash Lajme

Menaxhim i Sektorit të Sigurisë

Instituti Kosovar për Kërkime dhe Zhvillime të Politikave "KIPRED" ka publikuar më 13 dhjetor një raport për forcimin e mbikëqyrjes civile dhe menaxhimit të sektorit të sigurisë në Kosovë.

Ky raport shqyrton ofrimin e shërbimeve të sigurisë dhe mbikëqyrjen e organeve të sigurisë në Kosovën e sotme, duke analizuar se si mund të zhvillohet arkitektura e sigurisë në mënyrë që zëri i kosovarëve të dëgjohet si duhet në menaxhimin dhe mbikëqyrjen e sigurisë. Në pjesën hyrëse të punimit elaborohet mungesa e mbikëqyrjes civile në vend për të krahasuar pastaj veçoritë kryesore të zgjidhjeve të tanishme me ato nga e kaluara e afërt dhe të identifikojë prioritetet të cilat duhet të adresohen nëse dëshirohet që qeverisja të jetë më demokratike sesa deri më tani.

Në punim argumentohet se pavarësisht nga përparësitë e saj të mundshme, arkitektura e tanishme e sigurisë në Kosovë nuk e ka kaluar provimin e demokracisë, duke qenë se kosovarët janë vetëm pranues të shërbimeve të sigurisë dhe mbesin të privuar nga pjesëmarrja dhe kontrolli, gjë që bën të besohet se në këtë mënyrë jodemokratike ata nuk mund të vazhdojnë të qeverisen. Derisa bashkësia ndërkombëtare të mos fillojë të merret me përfundimin dhe përfaqësimin e ulët të kosovarëve në ofrimin, menaxhimin dhe mbikëqyrjen e sigurisë, nuk do të mund të pohohet arritja e suksesit në vendosjen e paqes. Shmangia e përfshirjes së mirëfilltë vendore dhe mbikëqyrja demokratike civile pas periudhës fillestare të stabilizimit të vendit është bërë pengesë për zhvillimin politik të vendit, sipas të gjitha gjasave në dëm të stabilitetit afatgjatë.

Ky punim vjen në kohën e fillimit të bisedimeve për statusin e ardhshëm të vendit, por edhe të fillimit të "Rishikimit të Sektorit të Sigurisë së Brendshme" nga Misioni i Kombeve të Bashkuara, që mëton të vendosë themelet e sistemit të sigurisë me llogaridhënie demokratike, duke hapur kështu rrugën për përmirësim rrethësor të institucioneve të sigurisë së vendit. Sfidat e vështira në të cilat do të hasë ky rishikim janë në qendër të vëmendjes së këtij raporti i cili synon t'i ndihmojë procesit në fjalë.

Teksti i plotë:
<http://www.kipred.net/UserFiles/File/SecSectorManagement.pdf>

Shoqëri Aktive

Avonet ndërton urë lidhëse ndërmjet qytetarëve të Ferizajit dhe ligjvënësve të tyre

Intervistë me koordinatorin e Avonet-it, Shaban Shabani

Shaban Shabani është qytetar aktiv i Ferizajit, përfshirja e të cilit në zhvillime të rëndësishme të shoqërisë civile ka ndikuar drejtpërdrejt në jetën e komunitetit të tij duke i afruar qytetarët dhe ligjvënësitë e tyre për të përmirësuar kushtet e komunitetit lokal.

Përfshirja e Shabanit në çështje të shoqërisë civile filloi kur ai ishte 17 vjeç, me aktivitetin për të rregulluar një park në qendër të qytetit. Tash, pas katër vjetësh, Shabani punon si koordinator për avokim të interesave të qytetarëve të Ferizajit, nëpërmjet rrjetit të OJQ-ve, Avonet, me qëllim që të ketë përmirësime të rëndësishme në jetën e komunitetit. Avoneti paanësisht monitoron Kuvendin Komunal të Ferizajit në zbatimin e ligjeve dhe rregulloreve lokale. Sipas Shabanit, kjo paanësi është arsyeja kryesore që Avonet

është rrjet i suksesshëm dhe i besuar i OJQ-ve.

"Avonet-it i janë nevojitur dy vjet për të ndërtonur besimin në

më përgjegjës ndaj shqetësimeve të qytetarëve. Këto rekomandime quan në vendimin e qeverisjes komunale që taktimet e saj të jenë të hapura për publik. Gjithashtu, Kuvendi Komunal ka caktuar një nën punës të ri, i cili punon me grupe të rinjsh për interesat e tyre. Avoneti po ashtu publikon fletënotime për anëtarët e Kuvendit, që t'i informojnë qytetarët për punën e secilit anëtar. Nga përfshirja fillestare në rregullimin e një parku deri te avokimi aktual për pjesëmarrje

më të madhe publike në vendimmarrje, përfshirja e Shabanit në aktivitete të shoqërisë civile është bërë pjesë e pandashme e përditshmërisë së tij. Ai ka porosi të qartë për shoqërinë civile kosovare - "Derisa nuk jeni aktiv, të drejtat tuaja të përcaktuara me ligj kurrë nuk do të realizohen".



Avoneti, përbëhet nga katër OJQ të Ferizajit: "Qendra Avokuese për Progres", "Handikos", "Ardhmëria Rinore" dhe "Etika", është themeluar në vitin 2002.

mesin e publikut, sikurse edhe për t'i bindur autoritetet lokale që të na konsiderojnë seriozisht", ka deklaruar Shabani. Disa nga të ariturat kryesore të Avonet-it në Ferizaj përfshijnë hapjen për publik të Komisionit Komunal të Politikave dhe Financave, publikimin e 7 raporteve monitoruese periodike dhe 2 vjetore me rekomandime specifike për Kuvendin Komunal se si të jetë

Të Drejtat e Njeriut

Dokumentim i të drejtave të njeriut nëpërmjet kinemasë

Këshilli për Mbrojtjen e të Drejtave dhe Lirive "KMDLNJ" organizoi edicionin e gjashtë të Festivalit Ndërkombëtar të Filmit Dokumentar për të Drejtat e Njeriut, i cili është mbajtur në Prishtinë nga 5 deri më 10 dhjetor

Tridhjetë filma janë shfaqur gjatë festivalit, shumica prej tyre ndërkombëtar. "Ikona e lotëve", ka fituar shpërblimin për filmin më të mirë dokumentar kosovar. Është ky një film për Ferdane Çerkezin nga Gjakova, katër djemtë dhe bashkëshorti i së cilës janë të zhdukur që nga lufta në Kosovë. Ndonëse çdo ditë kthehen vetëm të vdekur nga Serbia, ajo jeton me

shpresë se fëmijët dhe bashkëshorti do t'i kthehen të gjallë. "Treni për në Seul" ka fituar shpërblimin për filmin më të mirë dokumentar të huaj, i cili rrëfen për përpjekjet e dëshpëruara të qytetarëve të Koresë Veriore për t'u larguar nga vendi i tyre.



atrc

UD Drejtore
Ekzekutive/ShG IREX
 BARBARA HALL
 bhall@irex-kcsp.org

Zëvendës Drejtore
 RREZE DULI
 rreze@advocacy-center.org

Menaxher i Shërbimit të
Trajnimeve dhe Konsultimeve
 ILIR HOXHA
 ilir@advocacy-center.org

Trajnere & Konsultante
 MERITA BARILEVA
 merita@advocacy-center.org

Trajnere & Konsultante
 DONIKA SALIHU
 donika@advocacy-center.org

Bashkëpunëtorë e Programit
 NATYRA ZHJEQI
 natyra@advocacy-center.org

Menaxher i Financave & Administratës
 GANI ASLLANI
 gani@advocacy-center.org

Menaxher për IT dhe Databazë
 ARMEND SUSURI
 armend@advocacy-center.org

Menaxhere për Komunikim
 ARJETA DOROCI
 arjeta@advocacy-center.org

Rr. Agim Ramadani Nr. 15
Kati i II-të Prishtinë, Kosovë
Tel/Fax: +381 (0) 38 244 810

Zhvillime Ndërkombëtare të Shoqërisë Civile

Komisioni i Helsinkit i bën thirrje parlamentit rus që të rishqyrtoj ligjin për OJQ-të

Në votimin 370 me 18, Duma shtetërore ka miratuar në lexim të parë më 24 nëntor projektligjin, i cili obligon të gjitha OJQ-të që të ri regjistrohen në një komision shtetëror

Komisioni i Helsinkit në SHBA i ka bërë thirrje parlamentit rus që të rishqyrtoj ligjin që kontrollon organizatat jo qeveritare. Në një letër dërguar kryesuesit të Dumas shtetërore, dhomës së ulët të parlamentit rus, Komisioni ka thënë se ligji i ri i planifikuar "do të ketë efekt brengosës në shoqërinë civile në Federatën Ruse, përfshirë funksionimin e organizatave jo qeveritare të fokusuar në të drejtat e njeriut dhe demokraci... dhe seriozisht minon të drejtat e individëve në Rusi për shoqata të lira".

Edhe pse leximi i parë i ligjit të sapo propozuar ka kaluar në Duma, ai duhet të kalojë nëpër disa lexime të mëtejshme dhe të nënshkruhet nga kryetari rus Vladimir Putin para se të bëhet ligj.

Putin është zotuar të mbroj shoqërinë civile në kohën e reagimeve për aktivitetet e OJQ-ve. Ai ka thënë se do të sigurojë se çfarëdo hapi që të merret "nuk do të shkaktoj dëme në shoqërinë civile në Rusi". OJQ-të në Rusi thonë se ky projektligj do të pengojë aktivitetet e tyre. Më

shumë se 1.000 OJQ i kanë bërë thirrje Dumas që të hedh poshtë këtë projektligj.



Z. Putin brengoset për financimin e huaj të grupeve politike në Rusi

Burimi: Komisioni i Helsinkit dhe BBC Lajme, Edicioni Botëror

Shembull inovativ i Kroacisë i partneritetit OJQ/qeveri

Parlamenti kroat më 2003 miratoi Ligjin për Fondacionin Kombëtar për Zhvillim të Shoqërisë Civile, i cili është njëri ndër shembujt më novativ të partneritetit OJQ/qeveri në Evropën Qendrore dhe Lindore

Parlamenti kroat miratoi Ligjin për Fondacionin Kombëtar për Zhvillim të Shoqërisë Civile më 15 tetor, 2003. Miratimi i Ligjit shënon hap kritik përpara në zhvillimin e shoqërisë civile dhe në qëndrueshmërinë financiare të OJQ-ve në Kroaci. Fondacioni Kombëtar kroat për Zhvillimin e Shoqërisë Civile, konsiderohet njëri ndër shembujt më novativ të partneritetit OJQ/qeveri në rajonin e Evropës Qendrore dhe Lindore. Sipas Ligjit, fondacioni është themeluar ligj publik, misioni i të cilit është të shërbejë dhe zhvillojë shoqërinë civile në Kroaci. Fondacioni përkrah programe novative të zhvilluara nga OJQ-të dhe iniciativa joformale, të bazuara në komunitete.



Zagreb, Kryeqyteti i Kroacisë

Me financim prej fondeve buxhetore shtetërore, fondeve të lotarisë kroate, donacioneve private, të ardhurave nga aktivitetet ekonomike dhe burimeve të tjera të caktuara, Fondacioni punon në promovimin dhe qëndrueshmërinë e sektorit, bashkëpunimit mes sektorëve të ndryshëm, iniciativave qytetare, filantropinë dhe vullnetarizmin. Aktivitetet kryesore të Fondacionit përfshijnë: (1) arsimimin dhe botimet, (2) dhënien e granteve, (3) fushata për ngritjen e vetëdijes. Fondacioni udhëhi-

qet nga bordi menaxhues, i cili përbëhet prej përfaqësuesve nga qeveria dhe shoqëria civile; shumica e pozitave në bord janë të rezervuara për përfaqësues të shoqërisë civile. Për të siguruar vendimet për dhë-

nien e granteve, qoftë ato nga Fondacioni Kombëtar, ministritë, ose qeveria lokale, të bazuar në standarde të vendosura të transparencës, Kodi i Praktikave të Mira për Përgatitjen e Granteve është përgatitur dhe miratuar nga Parlamenti, me ndihmën e Qendrës Ndërkombëtare për Ligjin Jo-Fitim-Prurës dhe USAID-it.

Burimi: Qendra Ndërkombëtare për Ligjin Jo-Fitim-Prurës.